



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	06.02.2019
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Agim BAHTIRI – Kryetar i Komunës z. Faruk MUJKA – Nënkyetar i Komunës
KOPJE :	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Shukri GASHI – Drejtor i DFZHE
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për muajin Janar 2019

Të nderuar,

Gjeni të bashkangjitur raportin për muajin Janar 2019 nga Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.

Spektori për Buxhet dhe Financa

Është përgatitur lista e obligimeve të papaguara sipas Drejtorive Komunale dhe se totali i borxhit deri më 31.12.2018 është në vlerë 2,113,485.87 Euro:

1. Në kategorinë Mallra e Shërbime 418,723.95 Euro
2. Në kategorinë Shpenzime Komunale 1,044.69 Euro
3. Në kategorinë Subvencione dhe Transfere 117,948.86 Euro
4. Në kategorinë Investime Kapitale 1,575,768.37 Euro.

Në aspekt të të *hyrave vetanake* të Komunës janë bërë barazimet me të gjitha Drejtoritë Komunale. Realizimi i THV për Janar 2019 është 116,544.86 Euro.

Donacione të Jashtme janë në vlerë 4,038.90 Euro, të Brendshme për këtë muaj nuk ka pasur. Bashkëfinancime në këtë muaj nuk ka pasur.

Të hyrat nga gjambat në trafik për muajin Janar janë gjeneruar në sistem në vlerë 13,496.00 Euro.

Të hyrat vetanake në vlerë prej 116,544.86 Euro ende nuk janë alokuar.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë muajit Janar ka pranuar 332 fatura të reja nga Administrata e Përgjithshme në vlerë totale 363,934.65 Euro, 23 fatura nga Administrata e Arsimit në vlerë totale 13,628.41 euro ndërsa *Administrata e Shëndetësisë nuk ka pasur fatura hyrëse në LOGO gjatë muajit Janar.*

Tre fatura nuk janë evidentuar në LOGO edhe pse i kemi pranuar përmes librit. Fjala është për dy fatura të KRM "Uniteti" për asrsye të kontestimit të borxhit nga DSHPI dhe një faturë të KRU Mitrovica mban protokollin e Drejtorisë së Urbanizmit duke e ditur që kjo Drejtori me vite nuk ka buxhet të planifikuar në kategorine e Komunalive. Kjo situatë presim që të sqarohet gjatë muajit shkurt.

Janë përgatitur rreth 250 CPO duke përfshirë modulën e blerjes dhe aprovimit për të gjitha drejtoritë komunale.

Ne librin e protokollit janë pranuar 25 lëndë. Gjendja e lëndëve në intranet me datë 31.01.2019 është si në vijim:

1. Numri i lëndëve në proces 257;
2. Numri i lëndëve të miratuara 1,630;
3. Numri i lëndëve të refuzuara 2.

Janë proceduar tre kërkesa në MF për alokim të donacioneve nga Save the Children për mbulimin e pagave në: 1. SHFMU "Aziz Sylejmani" vlera 1,328.58 Euro; 2. SHFMU "Sefedin Smakolli" vlera 1,328.58 Euro dhe 3. SHFMU "Eqrem Qabej" vlera 1,381.74 Euro.

Në aspekt të **zotimeve të mjeteve** gjatë Janarit janë bërë 201 zotime duke përfshirë modulën e blerjes dhe atë të aprovimit.

Për muajin Janar Zyrtari Çertifikues ka raportuar se janë realizuar në procedurë të rregullt gjithsejt 120 lëndë në shumë totale prej 42,247.89 euro, sipas kategorive ekonomike në vijim :

- Mallra dhe Shërbime – 30,405.13 Euro
- Shpenzime Komunale – 9,534.76 Euro
- Subvencione dhe Transfere – 2,308.00 Euro
- Investime Kapitale – 0.00 Euro

Gjatë muajit Janar 2019 janë bërë disa kthime nga Thesari, këto kryesisht kanë qenë lëndë me gabime të llogarive bankare të përfituesve e të cilat pas përmirsimeve përsëri janë bërë pagesat.

Në aspekt të **Pasurisë**, zyrtarja për pasuri ka raportuar se janë pranuar dy Investime Kapitale nga MAPL në vlerë 76,832.13 Euro. Pasurija e Komunës vetëm për vitin 2018 është 3,047,647.64 - 69,145.94 (amortizimi) = 2,978,546.90 Euro.

Vazhdon një komunikim jo i mirë me zyrtarin e depos pasiqë sipas znj. Mikullovcit disa herë që e ka kërkuar nuk ka qenë në vendin e punës. Pastaj vazhdon dukurija e mos raportimit të pasurisë nga zyrtarët e Komunës në regjistrin e pasurisë.

Janë përgatitur dhe dorëzuar në MF, Pasqyrat Vjetore Financiare 2018.

Gjatë muajit Janar nga Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit janë ekzekutuar tre (3) lëndë në vlerë financiare 8,957.25 Euro.

Arkatarin kryesor ka raportuar se mjetet e dorëzuara në Arkë sipas Uniref, gjatë muajit tetor janë në shumën prej 17,742.10 € Arkatarin kryesor konfirmon se arka është barazuar me bankën dhe nuk ka ndonjë mospërputhje.

Në aspekt **të Pagave** dhe kompensimeve janë pranuar nga Zyra e Personelit 12 kërkesa e për të gjitha këto me kohë janë përgatitur formularët adekuat dhe janë dërguar në MF. Prej tyre 7 kërkesa kanë qenë për ndryshime, 2 kërkesa për punëtor të rinjë, dhe 2 kërkesa për ndrrim të llogarisë bankare. Janë printuar dhe shpërndarë në të gjitha Drejtoritë listat e pagave për muajin e kaluar. Gjithashtu janë nxjerr shënimet nga sistemi EDI për deklaratimet e punëtorëve jashtë listave të pagave.

Gjatë Janarit janë përgatitur 14 formular për regjistrim të furnitorit në SIMFK dhe janë dërguar në MF.

Spektori i Tatimit në Pronë

997 Objekte janë verifikuar.
50 Objekte janë regjistruar të reja.
15 Objekte ju ka ndrruar pronari.
Inkasimi i Tatimit në Pronë gjatë muajit Janar 2018 ka qenë **38,368.19 Euro**.

Vërejtje:
Per shkak të kushteve atmosferike dhe reshjes së borës një pjesë e stafit të terrenit ka punuar në zyre.

Spektori i Zhvillimit Ekonomik

Më poshtë është paraqitur raporti Mujor i zyrës për regjistrimin e biznesit

Regjistrim i biznesit	25	
Ndryshime në biznes	15	
Shuarje të biznesit	6	
Kërkesa të ndryshme	15	
Gjithsejt	61	

Zyrtarja për Buxhet dhe Financa

Bazuar ne Kriteret e punës, ne ligjet dhe rregulloret, detyrat dhe pergjegjesitë që dalin nga vendi i punës, kam nderin dhe kenaqesin te paraqes para jush raportin lidhur me aktivitetet dhe arritjet përgjatë muajit Janar 2019.

Sipas planë programit të punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhes raportuese kam zhvilluar dhe realizuar aktivitetet konform përgjegjësive dhe planifikimeve duke përmbushur një pjesë të madhe te detyrave me sukses në bashkëpunim me kolegët.

Aktivitetet Lidhur me Taksat ne Biznes :

- Përshkrimi i fletëpagesave (unirefit) për taksat .
- Pranimi i palëve dhe dhenja keshillave
- Pranimi i Lëndëve të drejtuara nga palët
- Përpilimi i shkresave dhe ofrimi i shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare.
- Analiza, Krahasimi dhe raportimi
- Arhivimi i dokumentacionit.
- Futja e të hyrave nga taksat në biznes në sistem –që sipas këtij muaji janë të inkasuara 2,296.81Euro.

Aktivitetet lidhur me ndryshimet në paga për muajin janar:

- Shtypja e listë pagave për muajin dhjetor dhe shpërndarja e tyre nëpër Drejtorin.
- Kontrollimi i ndryshimeve në listë të pagave, sa janë të realizuara ndryshimet e dërguara me formular për muajin dhjetor.
- Raportimi se sa janë të realizuar ndryshimet për muajin dhjetor
- Arhivimi i dokumenteve të përfunduara për paga në regjistrat.
- Pranimi i lëndëve me vendime për ndryshime në listë të pagave nga personeli.
- Përgatitja e formulareve për ndryshime në listë pagave sipas vendimeve për muajin Janar dhe dërgimi i formulareve në MAP.
- Skanimi dhe arhivimi i listë pagave për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015, 2016 dhe 2017.

Ndryshimet në paga për muajin Dhjetor	
Dokumentet e pranura nga Zyra Personelit	11
Formularët e Punuar	12
Formularët për Ndryshime në paga 2018	8
Formularët për punetore të rinje	2
Formularët për pagesa Retroaktiv	
Formularët për Ndrim të llogarisë	2
Formularët për largime	
Te Pranura në MAP	11

Aktivitete të tjera :

- Përgatitja e formulareve për hapje të ID-ve të furnitorit
- Përgatitja e fletëpagesave për qira nga banka

Me respekt
Drejtorja për F dhe ZH.E.